



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2114/ 5 prot

Datë 25.09.2025

**V E N D I M**  
**Nr. 1335/2025**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

|                  |            |
|------------------|------------|
| Fiorent Zguro    | Nënkryetar |
| Kreshnik Ternova | Anëtar     |
| Anila Malaj      | Anëtar     |
| Gjergj Mersini   | Anëtar     |

Në mbledhjen e datës 25.09.2025 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Muça” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-48707-05-22-2025, me objekt Loti I “Pajisje për zyrat” me fond limit: 15,408,601 (pesëmbëdhjetë milion e katërqind e tetë mijë e gjashtëqind e një) lekë pa TVSH ose 157,054.33 (njëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e pesëdhjetë e katër pikë tridhjetë e tre) euro pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 23.06.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Tiranë.  
Adresë: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Muça” SHPK me NIPT K01421002H, me adresë: Autostrada Tiranë – Durrës, km 13, Picar, Vorë.

**Subjekt i Interesuar:** Operatori ekonomik “M Lezha” SHPK me NIPT J76504013C, me adresë: Rruga “Lëvizja e Postribës”, Nr. Pasurisë 11/200, Zona Kadastrale 8592, Zona Industriale, Shkodër.

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

**Vëren:****I***Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

**II***Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 23.05.2025 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-48707-05-22-2025, me objekt Loti I “Pajisje për zyrat” me fond limit: 15,408,601 (pesëmbëdhjetë milion e katërqind e tetë mijë e gjashtëqind e një) lekë pa TVSH ose 157,054.33 (njëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e pesëdhjetë e katër pikë tridhjetë e tre) euro pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 23.06.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

II.2. Në datën 26.06.2025 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton se në datën 21.07.2025 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

|                                     |            |      |              |
|-------------------------------------|------------|------|--------------|
| 1- “Muça” SHPK                      | 7.638.500  | lekë | skualifikuar |
| 2- “Shaga” SHPK                     | 7.904.780  | lekë | skualifikuar |
| 3- “Buna” SHPK                      | 9.012.500  | lekë | skualifikuar |
| 4- “M. Lezha” SHPK                  | 10.633.000 | lekë | kualifikuar  |
| 5- “Albanian Furniture Office” SHPK | 10.900.000 | lekë | skualifikuar |
| 6- “Erzeni” SHPK                    | 11.080.000 | lekë | kualifikuar  |
| 7- “Irir Kaso” PF                   | 11.190.000 | lekë | skualifikuar |
| 8- “Ro Al” SHPK                     | 11.999.000 | lekë | skualifikuar |
| 9- “Eduart Xhixha” PF               | 12.308.000 | lekë | skualifikuar |

II.4. Në datën 21.07.2025 operatori ekonomik “Muça” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

#### ***Arsyet e skualifikimit***

- Operatori ekonomik “MUCA” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 2.2.3, ku percaktohet se: “Operatori ekonomik/Bashkimi i operatoreve ekonomike sipas artikujve që marrin persiper për furnizim, për artikujt e kërkuar si më poshtë duhet të paraqesë dokumentacion të akredituar si “Certifikate/Certifikate Testimi/Raport testimi” për produktet...”. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike rezlutoi se operatori ekonomik MUCA shpk nuk ka paraqitur dokumentacion të akredituar si “Certifikate/Certifikate Testimi/Raport testimi”, cka bie në kundërshtim me kërkesat e percaktuara në Dokumentet Standarte të Tenderit.

II.5. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton së më datë 01.08.2025 është Publikuar Njoftim Fituesi Paraprak i procedurës së prokurimit objekt- ankimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga ana e autoritetit kontraktor.

II.6. Në datën 05.08.2025, nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. A/2025/5643 dhe me nr. 2114/2025 prot, datë 06.08.2025, e operatorit ekonomik “Muça” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-48707-05-22-2025, me objekt Loti I “Pajisje për zyrat” me fond limit: 15,408,601 (pesëmbëdhjetë

*milion e katërqind e tetë mijë e gjashtëqind e një) lekë pa TVSH ose 157,054.33 (njëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e pesëdhjetë e katër pikë tridhjetë e tre) euro pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar më datë 23.06.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Muça” SHPK me pretendimet si vijon:*

*Se pari theksojme se vet citimi i KVO se, eshte i gabuar, pasi kerkesa 2.2.3 per te cilen shprehet KVO-ja, nuk ka te beje me certifikatat e produkteve, por eshte kerkese qe ka te beje me detyrimet e tarifave dhe taksave vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”. Kerkesa ne te cilen kerkohen certifikatat e produkteve eshte kerkesa 2.3.8. Fillimisht, i kujtojme anetareve te KSHA, se: Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efincencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”. Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me kushtetutën”.*

*Në nenin 77, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: ..... Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, sic është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”. Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave..... 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. 4. Oferta*

*konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të vecanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithcka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'iu përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kriteret dhe specifikimet teknike të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. KPP gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.*

*Nëse është e nevojshme, KVO kërkon sqarime nga ofertuesit,... Në cdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë. Gjithashtu, AK është i detyruar që në vlerësimin e ofertave, të bazohet vetëm në kërkesat për kualifikim të DT.*

*Ne kërkesat për kualifikim të DT perkates, nder te tjera, kerkohet: 2.3.8 “Kapaciteti teknik” Operatori ekonomik/Bashkimi i operatoreve ekonomike sipas artikujve që marrin persiper për furnizim, për artikujt e kerkuar si me poshte duhet te paraqese dokumentacion te akredituar si “Certifikate/Certifikate Testimi/Raport testimië per produktet: Karrige statike pa krahe mbeshtetes (Karrige), produkt i certifikuar ne perputhje me standardin SSH EN 1335-1:2020+A1:2022 (SSH EN 1335-1:2021) Mobilje zyre - Karrige pune për zyra - Pjesa 1: Dimensionet - përcaktimi i dimensioneve, ose e njevlefshme dhe e perditesuar, SSH EN 1335-2:2018 (Mobilje për zyra - Karrige për zyrë - Pjesa 2: kërkesat e sigurisë) ose e njevlefshme dhe e perditesuar - Tavoline pune e thjeshte (tavoline pune/zyre), produkt i certifikuar ne perputhje me standardin SSH EN 527-1:2011 Mobilje zyrash - Tavolinat e punës dhe tryezat - Pjesa 1: përmasat, ose e njevlefshme dhe e perditesuar SSH EN 527-2:2016 + A1:2019 Mobilje për zyra - Tavolina pune - Pjesa 2: kërkesat e sigurisë, fortësisë dhe qëndrueshmërisë ose e njevlefshme dhe e perditesuar - Sirtariere e levizeshme me rrota (Komedine/Sirtariere), produkt i certifikuar ne perputhje me standardin SSH EN 15338:2007 + A1:2010 (15338:2024) aksesore metalik për mobilje - Rezistenca dhe qëndrueshmëria e mekanizmave zgjatues (shinat) dhe komponentëve të tyre, ose e njevlefshme dhe e perditesuar.*

*Si dokument alternativ në vend të “Certifikate/Certifikate Testimi/Raport Testimi të produkteve koresponduese të standardeve të mesiperme, operatori ekonomik mund të paraqesë Certifikata me reference standarde të mesiperme ose ekuivalente (Certifikata ekuivalente konsiderohet certifikate që nuk i referohet sistemit europian EN të standardeve, por një sistemi*

*tjeter standardesh por qe trajton te njejtet tregues dhe norma te testuara dhe konfirmuara te produktit si ne sistemin EN) / te perditesuara sipas standarteve SSH/EN mbi konformitetin e standarteve europiane dhe te leshuara nga Organizma te Vleresimit te Konformitetit te akredituara per leshimin e ketyre dokumentave ne Republiken e Shqiperise ose Organizma Nderkombetare akreditues te njohura nga Republika e Shqiperise, si dhe dokumenta te tjere alternative si Certificate/Deklarate Konformiteti, Deklarate CE / Skeda Teknike, Pasaporta Teknologjike me kusht qe keta dokumenta alternative te jene te shoqeruara me Certifikatat e Testimit/Raportet e Testimit per secilin produkt me reference standardet e kerkuara si me sipër.*

*Certifikatat e kerkuara duhet te jene te vlefshme ne periudhes se realizimit te procedures se prokurimit. Certifikatat e mesiperme duhet te jene origjinale ose te njehsuara me origjinalin (kopje e noterizuar). Ne rastet kur oferta dorezohet nga nje BOE, operatoret duhet te disponojne*

*Dokumentacionin e kerkuar ne perputhje me raportin e pjesemarrjes ne furnizim, te percaktuara ne akt marreveshje. Ne permbushje te ketij kriteri, Muca shpk, ka paraqitur dokumentin “20-autorizime prodhuesi dhe certifikatat e standarteve ok”, (dokument bashkelidhur ofertes dhe kesaj ankese), ne te cilin ndodhen te gjitha certifikatat e siperpermenduara per produktet perkatese, shoqeruar edhe me autorizimet dhe deklaratat perkatese nga prodhuesit e te gjitha produkteve. Theksojme se te gjitha certifikatat e produkteve te paraqitura nga ana jone, jane konform standarteve nderkombetare te njohura nga Republika e Shqiperise, te perkthyer dhe te noterizuara. Nqs KVO-ja, do te kishte paqartesi ne lidhje me oferten tone, duhet te shfrytezonte hapsiren ligjore te permendur me lart , duke kerkuar sqarime. Anetaret e KVO-se, nuk kane denjuar as ta hapin ta shikojne se ç’permban dokumenti i lartpermendur. Ftojme anetaret e KSHA te AK, dhe me tej anetaret e KPP-se, te rivleresojne oferten tone duke e shpallur ate te kualifikuar. Pra ankesa jone duhet të pranohet.*

*Sa më sipër perfundimisht kërkohet:*

*Pranimin e ankesës.*

*Shfuqizimin e vendimit të KVO-se mbi skualifikimin e ofertës së OE - Muca, duke e shpallur te kualifikuar.*

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 2114/1 prot., datë 06.08.2025 janë publikuar arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “Muça” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 2114/2025 prot, datë 06.08.2025.

II.8. Me shkresën nr. 10792/9 prot, datë 25.08.2025 me objekt “Lidhur me ankesën e paraqitur për procedurën e prokurimit me objekt Blerje pajisje dhe orendi Loti 1 Pajisje për zyra”, protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me nr. 2114/2 prot datë 26.08.2025 autoriteti

kontraktor ka dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik, aktin e trajtimit të ankesës nr. 10792/10 prot, datë 25.08.2025 të operatorit ekonomik ankimues, nga verifikimi i të cilit rezulton se ka vendosur mospranimin e ankesës me argumentat si më poshtë vijon:

*Lidhur me pretendimin se:*

*Se pari theksojme se vet citimi i KVO është i gabuar, pasi kërkesa 2.2.3 për të cilën shprehet KVO-ja nuk ka të bëjë me certifikatat e produkteve, por është kërkesë që ka të bëjë me detyrimet e tarifave dhe taksave vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, KSHA konstaton se kemi të bëjmë me një lapsus, nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, pasi edhe në vijim të ankesës është shqyrtuar se behet fjalë për përmbushjen e kriterit 2.3.8 të kriterëve të veçanta për kualifikim, nga ana e operatorit ekonomik ankimues.*

*Lidhur me pretendimin se:*

*“Në përmbushje të këtij kriteri, Muça shpk ka paraqitur dokumentin 20-autorizime prodhuesi dhe certifikatat e standarteve ok (document bashkelidhur ofertes dhe kesaj ankese) në të cilin ndodhen të gjithë certifikatat e autorizimet dhe deklaratat perkatese nga prodhuesit e të gjithë paraqitura nga ana jone, janë konform standarteve nderkombetare të njohura nga Republika e Shqiperise, të perkthyer e të noterizuara.*

*Nqs KVO-ja do të kishte paqartësi në lidhje me ofertën tona duhet të shfrytëzonte hapësirën ligjore të përmendur më lart për të kërkuar sqarime.*

*Referuar Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nëni 79 parashikohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vertetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilesisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat të leshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi ndërkombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose ofertuesit”. Gjithashtu në VKM-në Nr.285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nëni 40, pika 2 dhe 3 parashikohet se: “2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve me të rëndësishme përberëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara. 3. Kërkesat e vesanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpyesetim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorit ekonomik për përmbushjen e këtyre kriterëve”.*

*Për sa më sipër, KSHA verën se operatori ekonomik në dokumentacionin e paraqitur në*

*Sistemin e Prokurimeve Elektronike, ne permbushje te kriterit 2.3.8 te Kriterëve te Veçanta te Kualifikimit ka dorezuar dokumentacionin si vijon:*

*1. Vërtetim Përkthimi me Nr. REP 3645 date 19.06.2025 te noterit A.S., ne referim te ligjit Nr.110 date 20.12.2018 “Per noterine” ne Republiken e Shqiperise, te dokumentacionit nga kompania turke “Goldsite”.*

*2. Vertetim Perkthimi me Nr. REP 1234 date 26.04.2022, te noterit D., te dokumentacionit nga kompania turke “Goldsite” per “Muca” shpk.*

*3. Vërtetim Perkthimi me Nr. REP 2025 date 09.06.2023 te noterit D., te dokumentacionit “Deklarate Konformiteti”.*

*4. Vërtetim Perkthimi me Nr. REP 3838 date 07.11.2024 te noterit D. Ç., te dokumentacionit “Shkrese leshuar nga shoqeria Line School and Office Furniture per MUCA shpk date 02.07.2024”.*

*5. Vërtetim Perkthimi me Nr. REP 2496 date 30.04.2025 te noterit A.S., te dokumentacionit nga kompania turke “Goldsite”.*

*Per sa siper, KSHA gjykon se, nga dokumentacioni i paraqitur ne Sistemin e Prokurimeve Elektronike, nga ankimuesi nuk arrin te provohet fakti se ky i fundit disponon “Certifikate/Certifikate Testimi/Raport testimi”, sipas percaktimeve ne kriterin 2.3.8, pasi nga shqyrtimi i dokumentave te sipercituar rezulton se certifikatat e konformitetit te paraqitura nuk specifikojne cilit operator ekonomik i janë leshuar.*

*Gjithashtu, referuar certifikatave dhe deklaratave te dorezuara nga ankimuesi, KSHA gjykon se pas shqyrtimit te tyre nuk arrin te provohet permbushja e standartave si vijon:*

*- Karrige statike pa krahe mbeshletes (Karrige), produkt i certifikuar ne perputhje me standardin SSH EN 1335-1:2020+A1:2022 (SSH EN 1335-1:2021) Mobilje zyre - Karrige pune per zyra - Pjesa 1: Dimensionet - Percaktimi i dimensioneve, ose e njevleshme ahe e perditësuar, SSH EN 1335-2:2018 (Mobilje per zyra - Karrige per zyre - Pjesa 2: Kerkesat e sigurise) ose e njevlefshme dhe e perditësuar.*

*- Tavoline pune e thjeshte (tavoline pune/zyre), produkt i certifikuar ne perputhje me standardin SSH EN 527-1:2011 Mobilje zyrash - Tavolinat e punës dhe tryezat - Pjesa 1: Permasat, ose e njevlefshme dhe e perditësuar SSH EN 327-2:2016 + A1:2019 Mobilje per zyra - Tavolina pune - Pjesa 2: Kerkesat e sigurise, fortesise dhe qendrueshmerise ose e njevlefshme dhe e perditësuar.*

- Sirtariere e levizeshme me rota (Komedine/Sirtariere), produkt i certifikuar ne perputhje me standardin SSH EN 15338:2007 + A1:2010 (15338:2024) Aksesore metalik per mobilje.

Ne procedurat e prokurimit te zhvilluara nga autoritetet kontraktore eshte e rendesishme qe, operatoret ekonomike me dokumentacionin e tyre, duhet te vertetojne se disponojne kapacitetet e nevojshme ligjore, financiare dhe teknike per realizimin e kontrates. Ne rastin konkret, KSHA konstaton se nepermjet dokumentacionit te dorezuar, operatori ekonomik "Muca" shpk nuk permbush specifikimet dhe kriteret e percaktuara ne piken 2.3.8. te DST.

KSHA sjelle ne vemendje se, mosplotesimi qofte edhe i nje kerkese te vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën te pavlefshme. Operatori ekonomik ankimues duhet të dorzonte te gjithë dokumentacionin e ofertes ne perputhje me kerketat e percaktuara ne dokumentat e tenderit. Gjithashtu referuar nenit 82, pika 2 te VKM-se Nr.285.2021 "Për miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, thuhet shprehimisht se: "Komisioni i vleresimit të ofertave verifikon dhe vlereson ofertat e dorezuara, duke kualifikuar vetem ato oferta, qe permbushin kerketat per kualifikim, te percaktuara ne dokumentet e tenderit dhe jane të pergjegjshme/vlefshme".

Referuar nenit 3, te Ligjit Nr.162 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet se:

"1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantone trajtim te barabarte dhe jodiskriminues për operatorët ekonomike, si dhe veprojne me transparence e ne minyre proporcionale". Gjithashtu sipas kriterëve te percaktuara ne Dokumentat Standarte te Tenderit, rastet e mosparaqitjes se nje dokumenti, ose dokumente false dhe te pasakta konsiderohen kushte per skualifikim.

Per sa me siper, Komisioni i Shqyrtimit te Ankeses vlereson se pretendimi i operatorit ankimues nuk qëndron.

Në baze te nenit 114, pika 3, germa c, te ligjin Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, pikes 2 dhe 4 te nenit 100 te VKM Nr. 285, date 19.5.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave:

#### Vendosi

1. Refuzimin e ankesës te operatorit ekonomik ankimues "Muca" shpk, per proceduren e prokurimit me objekt "Blerje pajisje dhe orendi; Loti 1: Pajisje per zyra", me nr. REF-48707-05-22-2025, zhvillar nga AK, Bashkia Tirane.

2. Autoriteti Kontraktor do te vere ne dijeni per vendimin e marre Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomik te interesuar (nese ka) brenda dites se nesërme të punës nga marrja e ketij vendimi, duke e shoqeruar me shpjegimet dhe dokumentacionin perkates.

3. Nje kopje e vendimit i komunikohet me shkrim ankimuesit dhe Komisionit te Prokurimit Publik.

II.9. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 për prokurimin publik.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Muça” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij, në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen se: *Operatori ekonomik “Muca” shpk nuk permbush Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 2.2.3, ku percaktohet se: “Operatori ekonomik/Bashkimi i operatoreve ekonomike sipas artikujve qe marrin persiper per furnizim, per artikujt e kerkuar si me poshte duhet te paraqese dokumentacion te akredituar si “Certifikate/Certifikate Testimi/Raport testimi” per produktet...”. Nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur ne sistemin e prokurimeve elektronike rezlutoi se operatori ekonomik Muca shpk nuk ka paraqitur dokumntacion te akredituar si “Certifikate/Certifikate Testimi/Raport testimi”, cka bie ne kundërshtim me kërkesat e percaktuar ane Dokumentet Standarte teTenderit*” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8/2 “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*”, pika 2.3.8 “*Kapaciteti teknik*”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

Operatori ekonomik/Bashkimi i operatoreve ekonomike sipas artikujve qe marrin persiper per furnizim, per artikujt e kerkuar si me poshte duhet te paraqese dokumentacion te akredituar si “*Certifikate/Certifikate Testimi/Raport testimi*” per produktet:

**Karrige statike pa krahe mbeshtetes (Karrige)**, produkt i certifikuar ne perputhje me standardin SSH EN 1335-1:2020+A1:2022 (SSH EN 1335-1:2021) Mobilje zyre - Karrige pune për zyra - Pjesa 1: Dimensionet - Përcaktimi i dimensioneve, ose e njevlefshme dhe e perditësuar, SSH EN 1335-2:2018 ( Mobilje për zyra - Karrige për zyrë - Pjesa 2: Kërkesat e sigurisë) ose e njevlefshme dhe e perditësuar

- **Tavoline pune e thjeshte (tavoline pune/zyre)**, produkt i certifikuar ne perputhje me standardin SSH EN 527-1:2011 Mobilje zyrash - Tavolinat e punës dhe tryezat - Pjesa 1: Përmasat, ose e njevlefshme dhe e perditësuar SSH EN 527-2:2016 + A1:2019 Mobilje për

zyra - Tavolina pune - Pjesa 2: Kërkesat e sigurisë, fortësisë dhe qëndrueshmërisë ose e njëvlefshme dhe e perditësuar

- **Sirtariere e levizeshme me rrota (Komedine/Sirtariere)**, produkt i certifikuar në përputhje me standardin SSH EN 15338:2007 + A1:2010 (15338:2024) Aksesorë metalik për mobilje – Rezistenca dhe qëndrueshmëria e mekanizmave zgjatues (shinat) dhe komponentëve të tyre, ose e njëvlefshme dhe e perditësuar.

*Si dokument alternativ në vend të “Certifikate/Certifikate testimi/Raport testimi” të produkteve koresponduese të standardeve të mesiperme, operatori ekonomik mund të paraqesë Certifikata me reference standarde të mesiperme ose ekuivalente (Certifikata ekuivalente konsiderohet certifikate që nuk i referohet sistemit evropian EN të standardeve, por një sistemi tjetër standardesh por që trajton të njëjtet tregues dhe norma të testuara dhe konfirmuara të produktit si në sistemin EN)/të “Perditësuar” sipas standarteve SSH/EN mbi konformitetin e standarteve evropiane dhe të leshuara nga Organizma të Vlerësimit të Konformitetit të akredituara për leshimin e këtyre dokumentave në Republikën e Shqipërisë ose Organizma Nderkombetare akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë, si dhe dokumenta të tjere alternative si “Certifikate/Deklarate Konformiteti”, “Deklarate CE” “Skeda Teknike”, “Pasaporta Teknologjike” me kusht që këta dokumenta alternative të jenë të shoqëruara me “Certifikatat e testimi/Raportet e Testimit” për secilin produkt me reference standarde të kërkuara si më sipër.*

**Certifikatat e kërkuara duhet të jenë të vlefshme në periudhën e realizimit të procedurës së prokurimit.** Certifikatat e mesiperme duhet të jenë origjinale ose të njehsuara me origjinalin (kopje e noterizuar). Në rastet kur oferta dorëzohet nga një BOE, operatorët duhet të disponojnë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me raportin e pjesëmarrjes në furnizim, të percaktuara në akt marrëveshje.

III.1.2. Në përmbushje të kriterit më sipër operatori ekonomik “Muça” SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik SPE dokumentacionin si më poshtë:

Autorizime prodhuesi dhe certifikatat e standarteve ok pdf 5.2 MB (me përmbajtje si më poshtë).

1. Vërtetim Përkthimi me Nr. REP 3838 datë 07.11.2024 të noterit D. Ç., të dokumentacionit autorizim prodhuesi i datës 02.07.2024 me përmbajtje “Në shoqëria Lina School and Office Furniture konfirmojmë se Muça SHPK me adresë autostrada Tiranë Durrës km 13, Tiranë, ka të gjitha të drejtat dhe është i autorizuar për të furnizuar dhe shitur të gjitha produktet tona në Shqipëri dhe në territorin e afërt”.
2. Veëtetim Përkthimi me Nr. REP 1234 datë 26.04.2022, të noterit D. Ç., të dokumentacionit autorizim prodhuesi i datës 19.04.2022 me përmbajtje “Në Goldsit Office Furnitures, pranojmë faktin se Muça SHPK me adresë autostrada Tiranë –

*Durrës, km 13, Tiranë, ka të drejtë si një firmë e autorizuar që të furnizojë dhe të shesë të gjitha produktet tona në Shqipëri dhe në territorin afër saj”.*

3. *Vërtetim Përkthimi me Nr. REP 2025 datë 09.06.2023 të noterit D. Ç., të dokumentacionit “Deklaratë Konformiteti” i datës 09.06.2023 me përmbajtje “Ne Goldsit Office Furniture, deklarojmë se produktet e prodhuara dhe të shitura nga ne, për të cilat shoqëria Muça SHPK është e autorizuar për shitjen në Shqipëri dhe në territoret afër saj, janë konformë standarteve CE. Bashkalidhur do të gjeni certifikatat përkatëse”.*
4. *Vërtetim Përkthimi me Nr. REP 2496 datë 30.04.2025 te noterit A. S., te dokumentacionit të kompanisë “Goldsit Office Furniture”.*
5. *Certifikatë Konformiteti TS EN 15338+A1/29.04.2010, e lëshuar nga trupa certifikuese TSE, e vlefshme deri më 22.11.2026, e akredituar si trupë certifikuese nga Agjencia Turke e Akreditimit, për standartin EN 15338+A1/29.04.2010 .*
6. *Certifikatë Konformiteti TS EN 1335-1+A1/08.12.2012, e lëshuar nga trupa certifikuese TSE, e vlefshme deri më 11.07.2025, e akredituar si trupë certifikuese nga Agjencia Turke e Akreditimit, për standartin EN 1335-1+A1/08.12.2012.*
7. *Certifikatë Konformiteti TS EN 527-1/13.03.2013, e lëshuar nga trupa certifikuese TSE, e vlefshme deri më 02.09.2025, e akredituar si trupë certifikuese nga Agjencia Turke e Akreditimit, për standartin EN 527-1/13.03.2013.*
8. *Vërtetim Përkthimi me Nr. REP 3645 datë 19.06.2025 të noterit A. S., të dokumentacionit të kompanisë “Goldsit Office Furniture”.*

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.4. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose

*dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.1.5. Në nenin 77, pikat 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

*“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*

*b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*

*c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së, i ndryshuar, përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.*

III.1.6. Neni 40 “Kërkesa të vecanta për kontratat e mallrave”, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. 4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor*

*si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

III.1.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai i barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.1.8. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në

dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garantitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që shërbimi/malli/puna e ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e kriterëve kualifikuese dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues, në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret kualifikuese dhe specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i shërbimeve/mallrave/punëve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret dhe specifikimet teknike të shërbimit të përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt prokurim. Në rastin konkret lidhur me pretendimin më sipër të operatorit ekonomik ankimues mbi certifikatat e produktit konform standarteve europiane, Komisioni i Prokurimit Publik konstatohet se referuar dokumentacionit nga ana e operatorit ekonomik ankimues “Muça” SHPK është dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike dokumenti i titulluar “Autorizime prodhuesi dhe certifikatat e standarteve ok pdf 5.2 MB”, bashkalidhur të cilit evidentohen ndër të tjera edhe **1. Certifikatë Konformiteti TS EN 15338+A1/29.04.2010, e lëshuar nga trupa certifikuese TSE, e vlefshme deri më 22.11.2026, e akredituar si trupë certifikuese nga Agjencia Turke e Akreditimit, për standartin EN 15338+A1/29.04.2010 . 2. Certifikatë Konformiteti TS EN 1335-1+A1/08.12.2012, e lëshuar nga trupa certifikuese TSE, e vlefshme deri më 11.07.2025, e akredituar si trupë certifikuese nga Agjencia Turke e Akreditimit, për standartin EN 1335-1+A1/08.12.2012. 3. Certifikatë Konformiteti TS EN 527-1/13.03.2013, e lëshuar nga trupa certifikuese TSE, e vlefshme deri më 02.09.2025, e akredituar si trupë certifikuese nga Agjencia Turke e Akreditimit, për standartin EN 527-1/13.03.2013.** KPP gjykon, se operatori ekonomik “Muça” SHPK me dokumentacionin e paraqitur, provon se ka përmbushur kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.8 të kapacitetit teknik.

Gjithashtu Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se përfituesi i drejtpërdrejtë i objektit të prokurimit është vetë autoriteti kontraktor dhe si i tillë ai ka një pozitë të veçantë dhe është përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të kontratës sipas legjislacionit në fuqi, kjo bazuar në nenin 124 të LPP-së ku përcaktohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të ndjekë zbatimin e kontratës sipas kushteve në bazë të të cilave është nënshkruar, për të

garantuar se ajo zbatohet në kohën, cilësinë dhe vlerën e përcaktuar, në përputhje me kushtet e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe me legjislacionin në fuqi. 2. Për monitorimin e zbatimit të kontratës, autoriteti ose enti kontraktor, nisur nga natyra e objektit të kontratës dhe kohëzgjatja e zbatimit të saj, harton planin e zbatimit të kontratës, duke përfshirë në veçanti çështjet organizative, afatet, çështjet ekonomike e teknike të kontratës së nënshkruar, në përputhje me çdo akt tjetër ligjor. 3. Plani i zbatimit të kontratës duhet të nënshkruhet nga autoriteti ose enti kontraktor dhe operatori ekonomik brenda 7 ditëve nga nënshkrimi i kontratës dhe në çdo rast para fillimit të zbatimit të saj. 4. Çdo modifikim i kontratës në përputhje me nenin 127 të këtij ligji, pasqyrohet në planin e zbatimit. 5. Autoriteti ose enti kontraktor, në përputhje me planin, ndjek zbatimin e kontratës, administron dokumentacionin e monitorimit dhe harton raportet e monitorimit. 6. Rregulla të hollësishme për monitorimin e zbatimit të kontratave, sipas tipologjive të tyre, përcaktohen nga rregullat e prokurimit publik. Autoriteti kontraktor duhet të kryejë pagesat në favor të operatorëve ekonomikë, në përputhje me parashikimet e legjislacionit të fushës në fuqi.” Pra është autoriteti kontraktor si organi me interes dhe përgjegjësi për realizimin me sukses të kontratës, është pikërisht ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës për t’u siguruar nëse cilësia e automjeteve të kërkuar në dokumentat e tenderit është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë. Sa më lart, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Muça” ShPK për përmbushjen e kriterit 2.3.8 do të konsiderohet i rregullt, duke plotësuar kështu këtë kriter të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Muça” ShPK qëndron

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos:**

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Muça” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-48707-05-22-2025, me objekt Loti I “Pajisje për zyrat” me fond limit: 15,408,601 (pesëmbëdhjetë milion e katërqind e tetë mijë e gjashtëqind e një) lekë pa TVSH ose 157,054.33 (njëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e pesëdhjetë e katër pikë tridhjetë e tre) euro pa

TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar më datë 23.06.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Muça” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Muça” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Nënkryetar**  
**Florent Zguro**

